



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 08.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.07.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Lulzim Katanolli B.I" për aktivitetin: "**Dezinfektimi i objekteve për nevojat e Komunes se Prishtinës**" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-096-221 nxjerr:

### VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Lulzim Katanolli B.I" e datës 07.07.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit **Dezinfektimi i objekteve për nevojat e Komunes se Prishtinës** me Nr. 616 20 3281 221, me Nr. Brendshëm : 616 -20-096-221.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin*.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "Lulzim Katanolli B.I" me datë 07.07.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Dezinfektimi i objekteve për nevojat e Komunes se Prishtinës**" me numër të prokurimit Nr. 616 20 3281 221 dhe numër të brendshëm 616 20 096 221.

Autoriteti Kontraktues, me datë 08.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar se kërkesa juaj është e pabazuar dhe tendencioze për arsyet në vijim:

1. Gramazha e cekur e perberjes aktive te dezinfektuesit nuk e kufizon numrin e dezinfektueseve, pasi qe ka nje game te gjere te dezinfektuesve me keto gramazhe apo me shume. Poashtu edhe materia aktive e kerkuar eshte materje qe shumica e dezifcenteve e kane dhe me kete AK nuk ka shkelur nenet apo ligjet e cekura nga ju. Ne mesin e 431 komponimeve gjenden edhe gramazha dhe materia aktive e cekur ne DT.

Nese na sygjeroni te perdoret peroksid i hidrogjenit (H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>) i komponimeve aktive te amoniumit te kombinuara me Glutaraldehyde atehere e kufizojme numrin e dezinfektueseve dhe me kete ju po mundoheni te interferoni per ndryshimin kriterive duke pershtatur kerkesave tuaja dhe kjo eshte ne kundershtrim me LPP Neni 7 .

Pretendimi 3 referojuni pergjigjes nr. 1

Pretendimi 3

AK ka specifikuar qe qellimi i ketij projekti eshte luftimi kunder Covid 19, specifikimi duhet te jete i pershkuar ne dokumentacionin percjelles sic eshte kerkuar pasi qe ky pershkrim eshte i ligjshem dhe profesional.

Bazuar ne keto sqarime u vendos si ne dispozitiv te Vendimit.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit